

VENDIM
Nr. 113, datë 3.6.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ENERGOVIA.ALBANIA” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/5 prot., datë 28.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Energovia.Albania’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energovia.Albania” sh.p.k. paraqiti në ERE kërkesë për njohjen e licencës për furnizim me energji elektrike, lëshuar nga Agjencia Serbe e Energjisë. Pas konfirmimit nga autoriteti serb se nuk është kompetent për njohjen e licencave të huaja, subjekti tërhoqi kërkesën dhe paraqiti aplikim të ri për licencim në tregtim energjie.

- ERE informoi subjektin mbi dokumentacionin dhe pagesat e nevojshme. Dokumentacioni i plotë u dorëzua më 12 maj 2025, ndërsa pagesa u verifikua më 28 maj 2025. Në këto kushte, konsiderohet e drejtë nisja e procedurës formale për shqyrtimin e aplikimit për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në përputhje me përcaktimet e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisje me licencë, duke plotësuar formularin sipas formatit të shtojcës 1 dhe deklaruar të dhënat e subjektit. Shoqëria ka konfirmuar angazhimin për respektimin e kuadrit ligjor dhe rregulloreve të ERE-së, si dhe ka kryer pagesën e mbetur më 15.5.2025, në përputhje me aneksin A të rregullores.

- Sipas nenit 9, pika 1.2, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar të vulosur nga QKB-ja më 29.4.2025, ku rezulton se shoqëria është regjistruar më 12.2.2024 si sh.p.k., me administrator dhe ortak z. T. A. Gjithashtu, është dorëzuar autorizimi noterial për përfaqësim, i përkthyer në gjuhën shqipe, i cili autorizon përfaqësues të shoqërisë për kryerjen e veprimeve në ERE dhe institucione të tjera shtetërore.

- Në përputhje me pikën 1.3, janë dorëzuar dokumentacioni financiar dhe fiskal, përfshirë pasqyrat financiare 2024, mbështetjen financiare për një muaj aktivitet, bilancet financiare të shoqërisë mëmë për vitet 2021–2023, si dhe plani i biznesit 2025–2029 me parashikime financiare për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në bazë të pikës 2.5, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në aktivitetin e tregtimit, duke paraqitur parashikimin e sasive të energjisë elektrike që synon të tregtojë gjatë periudhës pesëvjeçare të vlefshmërisë së licencës.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorin dhe në rast se ai nuk ka rezidencë në Shqipëri, duhet të depozitohet vërtetimi i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga autoritetet përkatëse të vendit të tij të rezidencës;

- germa “c”: Duhet të sqarohet se cila është struktura aktuale organizative e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k., të depozitohet sipas formës ligjore dhe, po ashtu, të depozitohet dokumentacioni përkatës për shërbimet e jashtme (si p.sh., kontratat e shërbimit).

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e përditësuar për shlyerjen e detyrimeve ndaj tatimeve dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërisë dhe shëndetësore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti